



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 361 Prot

Tiranë, më 01, 12, 2014

**VENDIM Nr. 361, datë 26.11.2014**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 26.11.2014, pasi shqyrtoi projektin "Shëtitore e Bregut të Drinit- Lezhë" paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Lezhë dhe informacionin në lidhje me inspektimin mbi gjetjet arkeologjike, gjatë punimeve për këtë projekt, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë projektin "Shëtitore e Bregut të Drinit- Lezhë". Punimet për këtë projekt të vazhdojnë, përveç zonës pranë urës së hekurit, ku është gjetur një strukturë muri, buzë lumit, në anën veriore të lagjes "Skënderbeg".
- II. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK Shkodër, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik .
- III. Në zonën ku është gjetur struktura e murit buzë lumit, në anën veriore të lagjes "Skënderbeg", të kryhet gërmimi arkeologjik i shpëtimit nga DRKK Shkodër dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, me mbështetjen e subjektit që po realizon punimet e këtij projekti. Raporti i gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitet në mbledhjen e ardhëshme të KKA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

- IV. Në pjesën prej 30m gjatësi të murit, të mos mbillen pemë rrepër, që mund të dobësojnë këtë strukturë.
- V. Shpenzimet për kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit do të financohen nga investitori, sipas Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47 dhe 48.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**